

Dr. Tony B. Watlington, Ed.D.
Superintendent

8 Korrik 2024

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Drejtoria Arsimore e Filadelfias është shumë e gëzuar të njoftojë ***Festimin e 4-të Vjetor të kthimit në shkollë dhe turneun me autobus!*** Mezi presim të dalim në rrugë dhe të ndihmojmë familjet të përgatiten për ditën e parë të vitit shkollor 2024-2025 – të Hënën, 26 Gusht 2024..



Ashtu si në vitet e mëparshme, Turneu mundësohet nga Fondacioni “Independence Blue Cross dhe sjell informacione dhe shërbime kritike të Kthimit në Shkollë drejt e në lagjen tuaj. Nga 29 korriku deri më 17 gusht, autobuzi do të udhëtojë nëpër Filadelfia duke organizuar 7 Mega-Evente plot argëtim të bashkë-sponsorizuar nga partnerë të ndryshëm duke përfshirë Radio One, Office Depot dhe Roosevelt Mall – si dhe një partner të ri këtë vit – Fashion District Philadelphia ! Në këto ngjarje ju mund të:

- shijoni “snack” dhe ushqimet e ngrira
- merrni pjesë në lojëra argëtuese dhe lotari
- bisedoni me Ambasadorët tanë të Ekipit të Rrugës për të marrë informacionin që ju nevojitet për kthimin në shkollë
- Regjistroni fëmijën tuaj për Parashkollorë deri në klasën e 12-të
- merrni pjesë në aktivitete edukative
- regjistroheni në Portalin prindëror
- të marrë ***falas*** çantë shpine dhe mjete shkollore
- merrni informacione kritike nga dhjetëra organizata tona partnere nga i gjithë qyteti
- fëmija juaj të marrë ***falas*** imunizimet dhe vizitat mjekësore të shkollës që kërkohen për të ndjekur shkollën dhe më shumë.

Gjeni orarin e plotë të turneut me autobus, përditësimet më të fundit për kthimin në shkollë, mundësitë e imunizimit dhe informacione të tjera të rëndësishme në philasd.org/ringthebell ose duke telefonuar 215-400-4000. Shpresoj t'ju shoh në një nga stacionet e turneut të autobuzit dhe mezi pres të fillojë një vit i ri shkollor këtë vjeshtë.

Në partneritet,

Tony

Tony B. Watlington Sr., Ed.D.

Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias